

Kampionati i minifutbollit “Porti dhe sporti”
“16 shtatori” i Shijakut – fituese mes 16 shkollave
09.12.2011



Nxënësit e shkollës së mesme “16 shtatori” të Shijakut janë shpallur sot në mesditë fitues të kampionatit të minifutbollit, në të cilin morrën pjesë 16 skuadra, nga po aq shkolla të rrethit të Durrësit.

Takimi final mes shkollave “Olsi Lasku” të Shkozetit dhe “16” shtatori” të Shijakut u zhvillua në pallatin e sportit “Ramazan Njala” të qytetit bregdetar, i cili ishte mbushur plot me sportdashës dhe bashkënxënës të futbollistëve të rinj. Bashkë me ta ndodheshin edhe prefekti i qarkut Genc Alizoti, deputeti Igli Cara, drejtori i APD, Eduard Ndreu dhe drejtori i DAR, Filip Gjonçaj.

Një sërë koreografish muzikore me vajza dhe djem të shkollave “Naim Frashëri” si dhe nga Qendra kulturore e fëmijëve të Shijakut shoqëruan të gjithë momentet e

pushimit të ndeshjes, duke krijuar një atmosferë të vërtetë festive në pallatin e sportit.

Të dy ekipet i dhanë jetë një takimi plot gjallëri, në përfundim të kohës së rregullt të të cilit nuk pati fitues.

Koha e rregullt përfundoi në barazim 4-4 dhe gjithçka u vendos nga goditjet e penalltive. Skuadra e shkollës “Olsi Lasku” kaloi tre herë radhazi në avantazh, dhe djemtë nga Shijaku barazuan në të gjitha rastet, por ata nuk mundën ta ruajnë rezultatin e përkohshëm 4-3 për ta në minutat e fundit të ndeshjes. Futbollistët e ekipit “Olsi Lasku”, të drejtuar nga trajneri Gjergj Barushi barazuan takimin, duke i drejtuar skuadrat në pikën e goditjes së penalltive.

Shijakasi gabuan shumë pak në gjuajtjet nga distanca 7 metra, duke i dhënë fitoren dhe Kupën e kampionatit shkollës së tyre me dy gola diferencë.

Nxënësit shijakas Xhino Saliu, Alvaro Demelezi, Robert Domi, Denis Arapi, Denis Tola, Andi Kalaja, Ergys Qylhani, Florian Kasa, Hamza Shahini dhe Sigrid Shahini, si dhe trajneri i tyre Gramoz Bega, u nderuan edhe me medaljet e fituesve të kampionatit “Porti dhe sporti”.

Në këtë kampionat që nisi më 4 nëntor morrën pjesë 16 skuadra të shkollave të mesme publike dhe jopublike nga rrethi i Durrësit. Veprimtaria u organizua nga drejtoria e Autoritetit Portual, dhe u mbështet nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Durrësit.

